



KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 397 Prot.

Tiranë, më 19 . 02 . 2026

V E N D I M

Nr. 39, Datë 19 . 02 . 2026

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 276 Regj., datë 25.11.2025¹, paraqitur nga z. M. K, kundër: Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës (UAMD), Bordit të Administrimit/UAMD, Senatit Akademik/UAMD dhe Fakultetit të Shkencave Politike dhe Juridike/UAMD, në të cilën pretendohet për diskriminim për “çdo shkak tjetër²”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna nga subjekti ankues, z. M. K, parashtrohet si më poshtë vijon:

“Ankuesi ka qenë student në Fakultetin e Drejtësisë, pranë Universitetit të Tiranës (FDUT), në vitet akademike 2019-2023.

¹ Plotësuar nga ankuesi me anë të e-mailit datë 04.12.2025.

² Ankuesi identifikon si cilësi të tij veçorinë që mbart, si student i transferuar nga Universiteti i Tiranës, në UAMD.

Me Urdhrin nr. 15/2023, të Dekanit të FDUT, ankuesi është çrregjistruar me dëshirë nga ky institucion. Në vijim, ankuesi ka paraqitur sërish kërkesë për t'u regjistruar në këtë institucion, por Dekani i FDUT, ka heshtur administrativisht, konflikt i cili është objekt gjykimi në Gjykatën e Lartë të Shqipërisë.

Ankuesi në vijim, i është drejtuar Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD), me kërkesë për të kryer transferimin në këtë institucion.

Komisioni i Njohjes së Lëndëve në FSHPJ/UAMD, nuk i ka njohur ankuesit të gjitha lëndët që ka dhënë në UT. Gjithashtu, sipas këtij Komisioni, ankuesi nuk përfiton nga e drejta për t'u përjashtuar nga tarifat e studimit.

Ankuesi sqaron se, kurrikulat e programit 5-vjeçar "Master i Shkencave në Drejtësi", nuk janë të unifikuara 100% në të gjitha universitetet publike. Për pasojë, një student që transferohet nga një universitet publik në një tjetër, është i detyruar t'i nënshtrohet detyrimeve të reja shtesë, pra, të përmbushë, në momentin që transferohet në një universitet tjetër, lëndët të cilat studenti nuk i ka pasur në kurrikulën e programit të Universitetit (Fakultetit) nga i cili është transferuar (në rastin konkret FD/UT). Në këtë kuptim, studenti detyrohet që t'i nënshtrohet detyrimeve të reja shtesë, në përkeqësim të situatës së tij juridike, duke iu nënshtruar kurrikulës së universitetit ku është transferuar, përmes përmbushjes së detyrimeve (shlyerjeve të krediteve/lëndëve) me efekt prapaveprues, ex tunc, njëllë sikur ky student të mos ketë qenë ndonjëherë i transferuar juridikisht. Në një situatë të tillë, ngjall dyshime serioze mbi pabarazinë në trajtim dhe nxit diskriminim të tërthortë.

Kjo situatë ka ndodhur me ankuesin M. K. Sipas UAMD, ankuesi konsiderohet si student përsëritës, ndonëse mesatarja e ankuesit është mbi nëntë. Detyrimet e prapambetura, siç kanë arsyetuar organet e UAMD, nuk lidhen në vetvete me qenien përsëritës, të ankuesit por me vetë faktin se ky Universitet e ka detyruar ankuesin t'i nënshtrohet me efekt prapaveprues, kurrikulës së tij, kurrikul e cila, nuk është e unifikuar.

Për këto arsye, ankuesi është aktualisht de facto, në vitin e 6 (gjashtë) akademik, për vitin 2025-2026, pra e ka tejkaluar kohëzgjatjen normale të studimeve për shkak të detyrimit për t'iu nënshtruar me efekt prapaveprues kurrikulës së UAMD. Kjo gjë është më se e natyrshme, por konsequenca e mos unifikimit të kurrikulave të programeve të studimit ndërmjet universiteteve publike me njëra-tjetrën, nuk mund të sjellin trajtimin dhe targetimin e studentit të transferuar si "student përsëritës", duke sjellë si pasojë mohimin e të drejtave ligjore dhe nënligjore që kuadri ligjor i njuh studentit.

Ankuesi ka drejtuar para FSHPJ/UAMD, dy kërkesa.

Fillimisht ka kërkuar përjashtimin/reduktimin e tarifave të studimit për vitin akademik 2024-2025, ku, pas verifikimit të dokumentacionit, Komisioni e ka refuzuar kërkesën e ankuesit, vendim i cili është ankimuar para Bordit të Administrimit/UAMD, i cili e ka lënë në fuqi atë, më datë 28.10.2025.

Në vijim, ankuesi ka drejtuar edhe për këtë vit akademik 2025-2026 një kërkesë të re, për përjashtim/reduktim të tarifave të studimit. Sërish Komisioni i FSHPJ/UAMD, e ka refuzuar kërkesën, me pretendimin se ankuesi është student përsëritës, pasi ka kaluar kohëzgjatjen normale të studimeve (5 vjet) pasi është në vitin e 6 (gjashtë) aktualisht, shkresë të cilën ankuesi do ta ankimojë sërish para Bordit të Administrimit/UAMD.”

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:

- *“Konstatimin e diskriminimit të tërthortë nga ana e FSHPJ/UAMD, Bordit të Administrimit të UAMD, Senatit Akademik të UAMD, Rektoratit të UAMD, ndaj ankuesit M. K, për shkak të cilësisë së tij, “student i transferuar” në UAMD.*
- *Marrjen e masave ligjore urgjente, duke detyruar organet publike të riparojnë shkeljet eventuale, sipas vlerësimit diskrecionar të KMD-së, duke përjashtuar/reduktuar studentin M. K, nga tarifat e studimit...”*

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

Pas analizimit paraprak të ankesës më sipër, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Me shkresën nr. 1642/1, datë 05.12.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar informacion dhe dokumentacion shkresor nga UAMD dhe strukturat përkatëse të tij, për sa i takon pretendimeve të subjektit ankues.
2. Me shkresën me nr. 2866/3 prot., datë 17.12.2025, UAMD, ka dërguar pranë KMD-së, parashtrimet dhe dokumentacionin respektiv, lidhur me sa është kërkuar nga Komisioneri.

3. Njëpëmjet e-mailit datë 10.01.2026, ankuesi ka informuar Komisionerin si vijon:

“...me anë të këtij email-i zyrtar, kërkoj nga Komisioneri marrjen e masave duke detyruar, personin juridik, UAMD dhe të gjithë subjektet kundër të cilëve drejtohet ankesa, të lejojnë aksesin e platformës elektronike “Pitagora”, për studentin M. K, me qëllim regjistrimin e lëndëve të semestrit të dytë të vitit akademik 2025-2026”.

Për shkak të ngutshmërisë së kërkesës, duke qenë se, në fund të janarit 2026, ankuesi M. K, i nënshtrohet provimeve të fundit, në degën e programit Master i Integruar në Drejtësi, duke patur parasysh, veçanërisht, kontekstin dhe historikun e tij specifik, në lidhje me shkeljet që i janë bërë ndër vite nga institucionet publike arsimore, ankuesi kërkon nga KMD marrjen e masës urgjente, provizore, duke kërkuar pikërisht sa sipër cituar.”

4. Pas informacionit sa më sipër, Komisioneri nëpërmjet shkresës me nr. 121 prot., datë 13.01.2026, i është drejtuar sërish UAMD-së dhe strukturave përkatëse të saj, duke kërkuar shprehimisht, që:

“Bazuar në sa parashtrohet nga subjekti ankues, si dhe nisur nga rrethanat konkrete specifike të rastit të tij, me qëllim mosparagjykimin e çështjes për shkak të ankimit të tij pranë KMD-së, si dhe mospenalizimin e tij si student lidhur me mundësinë për t’iu nënshtruar dhënies së provimeve të fundit të janarit 2026, në degën e programit Master i Integruar në Drejtësi/UAMD, Komisioneri, kërkon nga ana juaj që rasti të trajtohet me përparësi e efektivitet, në mënyrë që studentit M. K t’i lejohet aksesimi në platformën elektronike “Pitagora”, me qëllim regjistrimin e lëndëve të semestrit të dytë të vitit akademik 2025-2026.”.

5. Me shkresën me nr. 116/2 prot., datë 20.01.2026, UAMD, ka kthyer përgjigje për sa më sipër.

6. Në vijim të shqyrtimit të kësaj çështjeje, subjekti ankues, nëpërmjet email-it të datës 17.02.2026, ka paraqitur para Komisionerit kërkesën për tërheqjen nga ankesa e tij, duke shprehur, ndër të tjera, se:

“Pas ndërhyrjes institucionale të strukturave të brendshme të Universitetit, është lënë që çështja të zgjidhet mes palëve. Duke patur parasysh edhe faktin se, ankuesi M. K, për shkak të problemeve familjare dhe gjendjes shëndetësore të nënës së tij, nuk mund të qëndrojë më gjatë në procedim, në kushtet kur, është dakortësuar një rrugë e ndërmjetme me organet e universitetit, ankuesi, për t’u treguar i përgjegjshëm dhe serioz me institucionin e KMD-së, me qëllim për të mos harxhuar më tej, burimet njerëzore të institucionit, në njohje të plotë të pasojave juridike dhe ligjit nr.10221/2010, kërkon të pushohet gjykimi.

Ankuesi vlerëson të theksojë dhe falenderojë KMD për punën e tij, në mbrojtje të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.”.

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar përcaktohet: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, Komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Në nenin 94³/1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me

³ “Tërheqja e ankesës”.

kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.

Procedura administrative konkrete pranë Komisionerit, është iniciuar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, M. K, i cili, me anë të e-mailit të datës 17.02.2026, është tërhequr nga ankesa e tij pranë KMD-së.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, si dhe kërkesën për tërheqje nga ankesa të paraqitur nga ankuesi në datën 17.02.2026, Komisioneri vlerëson se, procedura për shqyrtimin e ankesës me nr. 276 regj., datë 25.11.2025, të paraqitur nga z. M. K, nuk mund të vazhdojë, por duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, për shkak se subjekti ankues është tërhequr nga ankesa dhe nuk identifikohet ndonjë interes publik që do të legjitimonte vazhdimin e procedurës, nga ana e këtij organi publik⁴.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja a) e nenin 33, pikat 9-10, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,
Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 276 Regj., datë 25.11.2025, të shtetasit M. K, pasi është tërhequr nga ankesa pranë KMD-së.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

⁴ Për analogji citojmë: Vendimin nr. 230, datë 07.11.2023, Vendimin nr. 104, datë 22.04.2024, Vendimin nr. 124, datë 30.04.2024, Vendimin nr. 146, datë 23.06.2025, Vendimin nr. 26, datë 10.02.2026, të KMD-së, të KMD-së.